

Data .06.02.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje Karburanti

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburante – 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

11.725.000(njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, pa TVSH..

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tepelenë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. (2019,2020,2021), ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit”.

Argumentimi: gjen zbatim ne nenin 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare” ;

- nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes”.

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ne nje vlere jo me pak se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime per realizim te suksesshem te kontrates të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jene te deklaruar ne organet tatimore.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jene te deklaruar ne organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përçindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin ne ecurine e punes se AK.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”

2.2.2.Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me Licence per tregëtimin me pakice te karburanteve, gazit te lengshem naftes per automjet, vajrave lubrifikant per perdorim nga konsumatorët fundore ose Autorizim per ushtrim aktiviteti “Tregti me pakice te lendeve djegese Karburante” .

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt. 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr. 970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë

licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2.3 Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht **1(një)** stacion të tregtimit me pakice të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Tepelenë, vertetur me një nga format e disponimit sipas kodit civil (kontrate noteriale qeraje ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës ;

Argumentim:

Duke qenë se Bashkia e Tepelenës ka një numër të konsiderueshëm mjedesh, do të ishte e nevojshme që, subjekti ofertues të ketë minimalisht 1 stacion të tregtimit me pakice të karburantit. Para vendosjes së këtij kriteri NJHD ka bërë hetim të tregut dhe ka konstatuar se me shumë se 4 katër operatorë kanë minimalisht 1(një) stacion të tregtimit me pakice të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Tepelenë.

2.2.4.”Stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit B të lëshuar nga QKL”

Argumentim

Ndryshimet sipas ligjit nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar

“1. Në përputhje me ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej dy nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipave A e B,

2.2.5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raport fletë-analizë për produktin Naftë Euro-Diesel D1 10PPM S.SH.EN:590-2013/A1:2017, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj duhet përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike të lëshuara jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave.

Argumentim:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotokopje të deklaratave doganore të produktit të furnizuar gjatë 6 muajve të fundit , këto dokumente OE nëse nuk është vetë importues mund ta marrë nga importuesi. Ky raport fletë-analizë për produktin , krijon siguri që karburanti të jetë me cilësi sipas normave ndërkombëtare, dhe sipas normave të përcaktuara nga ISHTI të jetë i importuar dhe jo karburant vendi.

2.2.6. Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Certifikaten ISO 9001: 2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te cilësisë, e cila te perfshije objektin e prokurimit, te jete e akredituar si dhe te jete e vlefshme.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.7. Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Certifikaten ISO 14001: 2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te mjedisit, e cila te perfshije objektin e prokurimit, te jete e akredituar si dhe te jete e vlefshme.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.8. Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Certifikaten ISO 45001: 2018 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune , e cila te perfshije objektin e prokurimit, te jete e akredituar si dhe te jete e vlefshme.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vëndndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.9. Subjekti ofertues duhet te paraqese dhe deklaratat si me poshte:

- Subjekti duhet te deklaroje se merr persiper furnizimin prane stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice ne sherbim 24 ore me karte elektronike te personalizuar me targon e cdo automjeti te autoritetit kontraktor, me karta elektronike ose/dhe me tollona, sipas kerkesave te autoritetit kontraktor.

Argumentim:

Referuar kerkeses se mesiperme duke qene se Autoriteti Kontraktor eshte ne sherbim operativ 24/7 lind nevoja e sherbimit 24 ore te furnizimit. Furnizimi i naftës do behet vetëm me karta elektronike ose/dhe me tollona.

- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet autoriteti kontraktor.

2.2.8 OE , Sipas përcaktimeve te pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,

autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

I. Njesia e Prokurimit ,

- Julinda Karteri
- Maksim Shehu
- Redion Haxhia